

lajmi.net

Arrestohen një i dyshuar për vrasje në tentativë dhe konfiskohet një armë



25/05/2023 15:02



Një person është arrestuar në rrugën “Bardhyl Qaushi” në Gjakovë sot pasi ka shtënë me armë zjarri ndaj një tjetri.

“Sot rreth orës 12:21 është pranuar informatë së në rrugën “Bardhyl Qaushi” në Gjakovë një person ishte qëlluar me armë zjarri.Njësitet e nevojshme policore menjëherë ju kanë përgjigjur rastit ku në vendin e ngjarjes janë gjetur dy gëzhoja si dhe është kuptuar se viktima mashkull i moshës madhore ishte qëlluar me armë zjarri. Viktima është dërguar në Spitalin Rajonal në Gjakovë, dhe nga personeli mjekësore jemi njoftuar se gjendja e tij shëndetësore për momentin është stabile (jashtë rrezikut për jetë)”, thuhet në njoftim.

Po ashtu Sektori Rajonal i Hetimeve, të mbështetur edhe nga njësitet tjera në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjakovë, pas një angazhimi operativ dhe hetimor rreth orës 14:00 kanë arritur të identifikojnë dhe të arrestojnë një të dyshuar lidhur me rastin në fjalë: A.N., mashkull i lindur në vitin 2001, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në posedim të të dyshuarit është gjetur dhe konfiskuar një pistoletë e cila dyshohet të jetë përdorur në rastin e përmendur dhe dy fishekë.

Lidhur me rastin është njoftuar edhe prokurorit i shtetit me vendimin e të cilit i dyshuari është ndalur në mbajtje për 48 orë si dhe është iniciuar rast “Vrasje në tentativë”.

Artikuj të ngjashëm



May 26, 2023

Ja “qet vulën” Liburn Aliu: Nuk do të ketë Autostradë të...



May 25, 2023

Asambleti i VV-së i kërkon meç boksi kreut të Prishtinës, Rama...



May 26, 2023

Mot i ndryshueshëm sot – këto pritet të jenë temperaturat



May 25, 2023

Liburn Aliu shuan shpresat e banorëve të Dukagjinit: Nuk do të...



May 26, 2023

Bujar Osmani sot në Kosovë, – takon Kurtin, Osmanin e Gërvallen



May 25, 2023

Gazetarja mbetet gojëhapur – qytetari nga Bujanoci i thotë se shet...


LAJME TË FUNDIT



Ja “qet vulën” Liburn Aliu: Nuk do të...



‘Marca’: Real Madridi arrin marrëveshje me Bellingham



Mot i ndryshueshëm sot – këto pritet të jenë temperaturat



Salah i zhgënjyer pasi Liverpools nuk arriti të sigurojë Ligën e Kampionëve



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information